

Tregtia me Pakicë

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)

INSTAT

Metadate Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	4
5. Periudha e referencës	4
6. Mandati institucional.....	4
7. Konfidencialiteti	4
8. Politika e botimit.....	5
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	5
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	5
11. Menaxhimi i cilësisë	6
12. Rëndësia.....	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	7
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	8
15. Kohëria dhe Krahasueshmëria.....	8
16. Kostoja dhe ngarkesa	9
17. Rishikimi i të dhënave.....	9
18. Përpunimi statistikor	10
19. Komente.....	11
Aneks	11

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave Afatshkurtra
1.3. Personi i kontaktit	Stesi Mici
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialist në Sektorin e Statistikave Afatshkurtra
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Shqipëri , ZIP Code, 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	smici@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / 240
1.8. Numri i faksit	+355 (4) 228 300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	12.03.2021
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	12.03.2020
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	12.03.2021
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Indeksi i tregtisë me pakicë tregon ecurinë e tregtisë së mallrave, ky indeks paraqitet si indeks volumi dhe vlerë, në formatin e botimit ky indeks pasqyrohet për nivel grupet e grupuara si: tregti me pakicë, tregti me pakicë pa hidrokarbure, tregti me pakicë ushqimore, tregti me pakicë jo ushqimore dhe tregti hidrokarburesh, të cilat vijnë si rezultat i përpunimit të dhjetë kategorive të mëposhtme të grupeve. Treguesit pasyrohen në formë indeksi dhe ndryshim në përqindje (%). Këto kategori përftohen nga klasifikimi i grupeve të veprimtarisë ekonomike (NVE Rev. 2, kodet 47.11-47.78). Dhjetë kategoritë e grupeve të klasifikuara të veprimtarisë ekonomike të Indekseve të të shitjeve dhe të volumit janë si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Artikuj të përzier kryesisht ushqime, pije, duhan në njësi tregtare jo të specializuara 2. Artikuj të përzier kryesisht jo ushqimore në njësi tregtare jo të specializuara 3. Ushqime pije e duhan në njësi tregtare të specializuara. 4. Pajisje kompjuterike, informatike dhe të komunikacionit

	<ol style="list-style-type: none"> 5. Paisje të ndryshme elektro-shtëpiake, mobiljet dhe pajisje të tjera shtëpiake 6. Libra, gazeta, artikuj shkollor, produkte të argëtimit, pajisje sportive, lodrat, lojrat dhe të tjera produkte industriale të kësaj natyre në njësi tregtare të specializuara 7. Veshje, këpucë dhe artikuj prej lëkure 8. Produkte farmaceutike, mjeksore dhe ortopedike, kozmetike, parfume dhe të tjera të higjenës personale 9. Artikuj të tjerë industrial në njësi tregtare të specializuara të pa klasifikuara në grupet e sipër përmendura 10. Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara
3.2. Sistemi i klasifikimit	NVE Rev.2 Klasifikimi statistikor i veprimtarive ekonomike zbatohet në përputhje me Rregulloren nr. 1893/2006 të Këshillit dhe të Parlamentit Evropian. Aplikimi i Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2, bëhet me akt ligjor të miratuar me VKM Nr 320 datë 28.05.2014.
3.3. Mbulimi i sektorit	Sipas klasifikimit të NVE.Rev. 2, Indeksi i tregtisë me pakicë (2015=100), mbulon veprimtaritë ekonomike të përfshira në kodet nga 4711 tek 4778.
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	Qëllimi i indeksit të tregtisë me pakicë është të tregojë ecurinë e tregtisë të mallrave. Indeksi nuk mbulon veprimtari të tjera, si sigurimi i shërbimeve etj. Indeksi përmbledh tërësinë e shumave të faturuara nga ndërmarrja gjatë periudhës së referencës, të cilat përkojnë me rishitjen e mallrave pa asnjë ndryshim tjetër. Të dhënat e mbledhura çdo muaj i referohen shitjeve të kryera, duke përjashtuar TVSH, duke përfshirë detyrimet dhe taksat e tjera të aplikuara mbi mallrat. Volumi i shitjeve paraqet vlerën e shitjeve, me çmime konstante, dhe është një indeks sasior. Volumi i indeksit mund të përlllogaritet me çmimin aktual, dhe të deflatohet përmes aplikimit të deflatorëve të shitjeve.
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore është ndërmarrja.
3.6. Popullata statistikore	Në anketën e kryer për përpilimin e Indeksit të shitjeve me pakicë (2015=100), u vendos të përfshihen ndërmarrje të shitjeve me pakicë të gjendura në Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve. Këto ndërmarrje i përkasin ndarjeve të veprimtarive ekonomike të kategorizuara përmes kodit katërshifror nga 4711 deri tek 4778 të klasifikimit statistikor të NVE Rev 2.
3.7. Zona e referencës	Të dhënat e Tregtisë me Pakicë mbulojnë të gjithë territorin e Shqipërisë.
3.8. Mbulimi në kohë	Seritë kohore të indekseve të shitjeve dhe volumeve në Tregtinë me Pakicë publikohen çdo tre muaj.
3.9. Periudha bazë	Viti bazë: 2015=100, aplikohet duke filluar nga tremujori i parë 2019.

4. Njësia matëse	Indekset, Ndryshimi në përqindje me të njëjtën periudhë të një viti më parë (%); Ndryshimi në përqindje me periudhën e mëparshme (%).
5. Periudha e referencës	Të dhënat i referohen periudhave tremujore, por mblidhen dhe publikohen të dhëna mujore. Ky raport i përket vitit referencë 2020.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Baza ligjore për prodhimin e treguesve të Tregtisë me pakicë, është pjesë e bazës ligjore të Statistikave Afatshkurtra :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” • Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2017-2021 <p>Klasifikimet dhe Përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e Këshillit Nr.1165 / 98 duke prezantuar Statistikat Afatshkurtra në nivel Evropian • Rregullorja e Komisionit Nr.1503 / 2006
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Nga tremujori i parë 2018 të dhënat transmetohen rregullisht në Eurostat për treguesit kryesorë.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura nga njësitë statistikore konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikën zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT mbron dhe nuk u shpërndan palëve të treta të dhënat e mbledhura nga, apo tek të cilat ka akses, të dhëna këto që mund të shërbejnë në identifikimin drejtpërsëdrejti apo tërthorazi të njësive statistikore që i kanë ofruar të dhënat në fjalë për arsye dhe qëllime statistikore, apo të dhëna të vjela nga burime të tjera administrative. INSTAT ndërmerr tërë masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga Instituti i statistikave vetëm në rast se:</p> <p>a) këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në</p>

	<p>lidhje me konfidencialitetin statistikor;</p> <p>b) njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave. Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesit tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i Institutit të statistikave. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojnë shkallën e detajeve që mund të shpërdahet dhe të bëhet publike nga Instituti i statistikave, me qëllim që të bëhet i pamundur identifikimi i njësisë statistikore nga këto të dhëna.</p>
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendari i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendarin. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesit në kalendarin e publikimeve	Kalendari i publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Aksesit i përdoruesve	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Website – online release; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Publikimi; 4. Kërkesa për të dhëna, seksioni për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshësia e shpërndarjes	Indeksi i Shitjeve dhe në Volum i Tregtisë me Pakicë shpërndahet çdo tre muaj.
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Sipas kalendarit të publikimeve, çdo tremujor publikohet njoftim për media mbi Indeksi i Shitjeve dhe në Volum i Tregtisë me Pakicë. Formatit i njoftimit për shtyp përcaktohet nga sektori i publikimit, i cili vendos edhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp i Indeksi i Shitjeve dhe në Volum i Tregtisë me Pakicë publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	<p>Të dhënat publikohen në faqen zyrtare të INSTAT sipas rregulloreve dhe ligjit referues:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Publikimi Tremujor i Tregtisë me Pakicë • Vjetari Rajonal Statistikor, 2020

10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis, për përdoruesit e jashtëm në faqen e internetit ofrohet seria kohore e Indekseve të Tregtisë me Pakicë në vlerë dhe në volum. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik. Bazën e të dhënave e aksesoni në linkun: Databaza Statistikore
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të dhënat mikro nuk janë publike për përdoruesin.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për Kontakt .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Metodologjia e Indeksit të Shitjeve dhe volumit në Tregtinë me Pakicë është e bazuar në, Methodology of Short-term Business Statistics, Interpretation and guidelines (Metodologjia e Statistikave Afatshkurtra të Biznesit, Interpretime dhe Udhërrëfime), 2006, i cili përmban një manual gjithëpërfshirës të rekomandimeve për përpilimin e statistikave Afatshkurtra. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me Metodologjinë mbi vrojtimin.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave Afatshkurtra dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e Tregtisë me pakicë për qëllime të brendshme.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës (kostos) së të intervistuarve. Kontrollat e cilësisë dhe vleftësimi i të dhënave janë veprime që kryen përgjatë tërë procesit. Stafit i përfshirë në fazën të ndryshme të përpilimit të indeksit, - të këtilla si mbledhja e të dhënave, kontrollat fillestare, hedhja e të dhënave dhe kontrollat përfundimtare që shoqërojnë përlogaritjen e indeksit, - është i mirë trajnuar dhe me përvojën e duhur. Kjo i jep mundësinë stafit që të përftojë një pamje të plotë dhe në vijimësi rreth ndërmarrjeve dhe përgjegjësi të tyre.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Indeksi i shitjeve në tregtinë me pakicë përpilohet qysh prej vitit 1999, që do të thotë se ka një përvojë të shtrirë në vite. Krahas kësaj, konceptet dhe metodologjia e përdorur janë zhvilluar në përputhje me standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, redaktimi dhe vleftësimi i të dhënave kryhet ose gjatë, ose pas hedhjes së të dhënave, përmes kontrolleve logjike. Kontrolli i të dhënave nënkupton studimin e vazhdueshëm të të dhënave të përcjella nga stafit

	<p>7 përgjegjës me synimin për të nxjerrë në pah gabimet e mundshme, sidomos ato që kanë peshë në rezultatet e përftuara. Mbas vërejtjes së gabimeve, kryhet një verifikim i mëtejshëm në bashkëpunim me ndërmarrjet, me qëllim saktësimin e të dhënave tek të cilat është vërejtur gabimi.</p>
<h2>12. Rëndësia</h2>	
<p>12.1. Nevojat e përdoruesit</p>	<p>Indeksi i volumit në Tregtinë me Pakicë ofron informacion statistikor të nevojshëm për përmirësimin e konkurrencës dhe performancës së bashkësisë së ndërmarrjeve. Indeksi përdoret nga përdorues të ndryshëm, të këtillë si qeveria dhe autoritetet e tjera administrative, Banka e Shqipërisë, analistë të ekonomisë, kërkuesit shkencorë media dhe publiku i gjerë.</p>
<p>12.2. Kënaqësia e përdoruesit</p>	<p>Page Views (Klikime) në lidhje me Tregtia me pakicë për vitin 2020 janë rreth 22,046 klikime. INSTAT realizon Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve.</p> <p>Gjatë 2020 INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e Statistikave të Tregtisë me pakicë është vlerësuar me 3.69 (73.8%) nga një shkallë prej 1 (shumë e dobët) në 5 (shumë e mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve.</p>
<p>12.3. Plotshmëria</p>	<p>Publikimet e Tregtisë me Pakicë janë të ndërtuara në përputhshmëri me standardet e evropiane si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e Këshillit Evropian Nr.1165/98 • Rregullorja e Komisionit Evropian Nr.1503/2006 <p>Shkalla e plotshmërisë të të dhënave, për Tregtinë me Pakicë 2020, është 80.0%. Kjo përlllogaritja ka marr në konsideratë vetëm aneksin C që kërkohet nga EUROSTAT.</p>
<h2>13. Saktësia dhe besueshmëria</h2>	
<p>13.1. Saktësia e përgjithshme</p>	<p>Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishme në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime të dhënat e anketës kontrollohen me pasqyrat financiare ose me burime administrative nëse ka informacion.</p> <p>Llogaritja e vlerësimeve të të dhënave statistikore dhe analiza e njesive outlier kryhet rregullisht. Shkalla e saktësisë së përgjithshme është e lartë, duke marrë parasysh shkallën e lartë të përgjigjes. Për të llogaritur vlerësimet, përdoret vlerësuesi Horvitz-Thompson, që është i paanshëm. Saktësia e vlerësimeve arrihet duke eliminuar gabimet e kampionimit dhe të jo kampionimit, të tilla si mbulimi, pa përgjigje, gabimet e përgjigjes dhe gabimet e përpunimit.</p> <p>Arsyet e shfaqes së gabimeve në mbulim janë keq klasifikimi i njesive dhe ndryshimet në statusin e njesive raportuese. Është e detyrueshme t'i përgjigjes vrojtimit. Në rast mos-përgjigje, njësitë kontaktohen përmes telefonit dhe postës elektronike. Gabimi në kampionim në përqindje (CV) llogaritet për treguesit</p>

	kryesorë të vrojtimit që publikohen çdo tremujor.								
13.2. Gabim i kampionimit	Të gjitha vlerat e treguesve përgjithësohen për të përfaqësuar gjithë popullatën në studim. Devijimi standard relativ (CV) mesatarisht për variablin shitje neto është 1.26 %.								
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Mos-përgjigja në nivel rekordi merr në konsideratë ndërmarrjet që nuk janë në gjendje apo të gatshme për të dhënë përgjigje, ose kur intervistuesit nuk janë në gjendje për të gjetur ndërmarrjet, ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën.</p> <p>Shkalla e mos-përgjigjes në nivel rekordi mesatarisht për Tregtinë me Pakicë 2020 është 5.11%.</p> <p>Shkalla e Mos-përgjigjes në nivel variabli mesatarisht për variablat kryesorë të Tregtisë me Pakicë janë: për Numrin e të punësuarve gjithsej është 4.54%, ndërsa për Shitjet neto është 4.47%.</p>								
14. Afatet kohore dhe përpikmëria									
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e Indeksi i volumit në Tregtinë me Pakicë janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 71 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 71 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Indeksi i volumit në Tregtinë me Pakicë është 31 Dhjetori 2020.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2020</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>03/12/2021</td> </tr> <tr> <td>Afatet Kohore</td> <td>71</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2020	Data e publikimit	03/12/2021	Afatet Kohore	71		
Periudha referuese	12/31/2020								
Data e publikimit	03/12/2021								
Afatet Kohore	71								
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat e Indeksi i volumit në Tregtinë me Pakicë, publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Indeksi i volumit në Tregtinë me Pakicë ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2020</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>03/12/2021</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>03/12/2021</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2020	Data e shpallur	03/12/2021	Data e publikimit	03/12/2021	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2020								
Data e shpallur	03/12/2021								
Data e publikimit	03/12/2021								
Vonesa në kohë	0								
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria									
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Indeksi i shitjeve në tregtinë me pakicë dhe indeksi i volumit janë në nivel kombëtar.								
15.2. Krahasueshmëria kohore	Seria e të dhënave është përpiluar që nga viti 1999. Grupi i parë i indikatorëve është bazuar në NVE Rev 1. Për kodifikimin nga NVE Rev. 1.1 në NVE Rev. 2 të indeksit të shitjeve dhe volumit në Tregtinë me Pakicë (2010=100), ka qenë e nevojshme që të përlllogariten seri paralele për këto indekse duke përfshirë dhe duke përjashtuar hidrokarburet. Kjo është bërë për shkak të përfshirjes së hidrokarbureve në Tregtinë me Pakicë, në mënyrë që të mbeteshin të								

	<p>krahasueshme me seritë pararendëse të indeksit të shitjeve dhe të volumit në tregtinë me pakicë (2005=100) dhe indekseve të llogaritura me NVE Rev.1.1. Procesi i kalimit nga baza e vjetër në bazë re përbëhet nga dy hapa: ripeshimi, p.sh. Peshat e përdorura për llogaritjen e indekseve përditësohen nga viti bazë 2005 deri në vitin bazë 2010; dhe ri-referenca, dmth. periudhat e referencës përditësohen nga viti 2005 = 100 deri në vitin 2010 = 100.</p> <p>Në vitin 2019 në SASH përditësohet struktura e peshave dhe ndryshon periudha bazë e indekseve nga 2010 në 2015. Seritë e të dhënave janë ekuivalente me njëra-tjetrën; ritmet e rritjes janë të njëjta dhe një seri është e konvertueshme në tjetrën.</p>
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Kontrolle të rregullta të ndërthurura bëhen me informacione të marra nga anketa të tjera. Rezultatet e Tregtisë me Pakicë krahasohen me shifrat relative sipas grupeve me Anketën Strukturore pranë Ndërmarrjeve.
15.4. Koherenca e brendshme	Bëhen krahasime të vazhdueshme ndërmjet muajve dhe të dhënave tremujore të deklaruara nga ndërmarrja.
16. Kostoja dhe ngarkesa	<p>Spektori i Statistikat Afatshkurtra është pjesë e Drejtorisë së Statistikave Ekonomike, ndërsa sa i përket grumbullimit të të dhënave, menaxhohen nga Drejtoria e Statistikave Rajonale. Staf i përfshirë në procedurat e mbledhjes së të dhënave, kontrollit të të dhënave, përditësimit dhe mirëmbajtjes së statistikave punon me kohë të plotë dhe të pjesshme (anketuesit).</p> <p>Numri i stafit: Gjithsej 21 të punësuar nga të cilët:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Specialistë 1 të punësuar 2. Kontrollorë 4 të punësuar <p>Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet INSTAT, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve krijojnë mundësinë e transmetimit të të dhënave pa kosto. Burimet Statistike (të Regjistrimit të Ndërmarrjeve, Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve etj.) ofrohen gjithashtu pa kosto, si pjesë e përdoruesve të brendshëm. Përpunimi, estimimi, kontrolli, analizimi, vlerësimi, dhe përpilimi i të dhënave, bëhet nga stafi me kohë të plotë i SASH dhe nuk i nënshtrohet asnjë kostoje shtesë.</p>
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e përgjithshme të rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantura nga INSTAT si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e revizionimit • Politika e trajtimit të gabimeve
17.2. Praktika e rishikimit	Të dhënat e publikuara nuk konsiderohen përfundimtare ato mund të rishikohen. Të dhënat mund të rishikohen për një sërë arsyesh si: implementimi i klasifikimit të ri NVE, ndryshime metodologjike, burime të reja informacioni ose të përmirësimeve të të dhënave dhe korrigjime të gabimeve. Rishikimi i

	tremujorit paraardhës është i mundur të kryhet gjatë çdo tremujori dhe në fund të çdo viti mund të kryhen korrigjime për të katërt tremujorët.
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Vrojtim tremujor statistikor. Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku kampioni për ndërmarrjet me 1 - 4 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 5 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat grumbullohen çdo tre muaj, por informacioni mblidhet për çdo muaj.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Gjatë vitit 2020, të dhënat janë siguruar në mënyrë të kombinuar nëpërmjet burimeve administrative dhe intervistave me telefon. Kohëzgjatja e intervistimit me telefon ishte 15 ditë pas tremujorit referues dhe u krye vetëm për ndërmarrjet të cilat nuk ishin subjekt i deklaramentit në burimet administrative.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Vlefhtësia e të dhënave bëhet duke krahasuar të dhënat e vlerave aktuale me ato të tremujorëve pararendës, dhe me tremujorët e njëjtë të vitit paraardhës. Në raste të vlerave të largëta (outlier) ndiqen komunikime me të anketuarit. Gjithashtu, një krahasim tjetër bëhet ndërmjet të dhënave aktuale me të dhënat e burimeve administrative (të dhënat e TVSH-së dhe skedarit të sigurimeve shoqërore) që i përkohjnë të njëjtës periudhë.
18.5. Përpilimi i të dhënave	<p>Nivel Kombëtar</p> <p>Hapi i parë është mbledhja e informacionit nga burimet administrative dhe intervista me telefon të ndërmarrjeve. Qëllimi është për të sjellë këtë informacion në nivelin statistikor. Proçesi i ndjekur është si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrolli logjik i informacionit të mbledhur me intervista në telefon (kontrolli i shënimit logjik të indikatorëve të përgjigjes si dhe kontrolli i plotësisht të shifrave). • Pas hedhjes së të dhënave, gabimet dhe mospërputhjet evidentohen dhe korrigjohen përgjatë redaktimit (editimit). • Krahasueshmëria e të dhënave (analizë e të dhënave me periudhat e mëparshme ose trendet). • Analiza e rezultateve për çdo fushë publikimi (domein). • Rezultatet e plota dhe të pastra të të dhënave shërbejnë më pas për fazën e peshimit dhe ri-peshimit • Të dhënat e agreguara krahasohen me të dhëna nga burime të tjera • Dy fazat e fundit mund të jenë subjekt analizash të tjera, në funksion të rezultateve sipas fushave të publikimit (domein-et). <p>Së fundi, kur analiza statistikore ka përfunduar, këto të dhëna përcaktohen si grup informacioni jo-publike. Para shpërndarjes së rezultateve, fazë shumë e rëndësishme është ruajtja e konfidencialitetit të këtij informacioni.</p>

18.6. Rregullimi	<p>Përshtatja sezonale dhe kalendarike në seritë mujore / tremujore të Tregtisë me pakicë u zbatua duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.2.0. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspecifikimin X-13 në serinë kohore. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme. Në serinë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative). Përshtatjet janë në drejtim të ndikimeve sezonale dhe kalendarike në pasqyrimin e statistikave tremujore. Për përshtatjet sezonale të serive është përdorur qasja direkte. Për përshtatjen kalendarike është përdorur specifikimi i ditëve tregtare dhe kalendari kombëtar, duke marrë në konsideratë si festat fikse dhe ato të lëvizshme. Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e vecanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.</p>
19. Komete	
Aneks	